

STATUTI I SHOQËRISË “HFM” SHPK

Në këtë statut:

- “Ligji” është ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është ky statut i shoqërisë;
- “Shoqëria” është shoqëria “**HFM**” **Shpk**, për rregullimin e së cilës hartohet ky statut;
- “QKR” është Qendra Kombëtare e Regjistrimit e cila është themeluar dhe vepron në bazë të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Sot, më datë 25.03.2025, **Fatjon Jonuzi**, Ortaku i vetem i Shoqërisë “**HFM**” **SHPK**, vendosen te formulojne Statutin e Shoqërisë me përmbajtjen si vijon:

TITULLI I ORTAKËT, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA, DHE HAPËSIRA NË INTERNET

Neni 1

Ortaku i shoqërisë

Z. Fatjon Jonuzi atesia Muharrem lindur në Trene, ALB me 30.06.1978 banues në Tirane madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Pasaportes nr BB6317120, nr. personal H80630056N.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:

1.Në fushën e ndërtimit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, ndërtimi i ambjentëve dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme në fushën e sportive, dhe të gjitha veprave të tjera madhore, ujësjellësive, Ujrave mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujëtare, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe çdo ndërtim tjetër i cili në përfundim përbën send të paluajtshëm sipas Kodit Civil për shkak të trupëzimit në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën ku është vendosur.

2 Në fushën e minierave shoqëria do të kryejë: Studimin, zbatimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të minierave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndërtimin dhe shfrytëzimin e minierave publike dhe private për të tëra lloje



shfrytëzimin e burimeve natyrore të ujrave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, përpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve të papërpunuara dhe të përpunuara.

3 Në fushën e turizmit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukturës dhe/ose të pjesëve perberese të saj, për shfrytëzimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, të Shqipërisë dhe më gjerë, për realizimin e hotelerisë, fshate turistike, qendra turistike e të tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve të nevojshem, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi të shitjeve të konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industrial e të tjera të kësaj natyre; Në fushën e agroturizmit dhe hotelerisë do të ushtroje sipërmarrjen ndertuese dhe zhvilluese . Krijimin e agjencive turistike e të tjera.

4 Në fushën e transportit, shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukturës dhe/ose të pjesëve përbërëse të saj, për transportimin publik dhe/ose privat të njerezve dhe mallrave si dhe tranzitimin e tyre përgjate territorit të Shqipërisë nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Shoqëria gjithashtu do të kryejë dhe duke mos u kufizuar vetëm në, aktivitetet e mëposhtme: - Ngarkim dhe shkarkim të anijeve; Pritje dhe levrim të ngarkesave nga dhe për në anije; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numërim, pritje, përpunim, dhe lëvrim i ngarkesave nga dhe nëpër anije.- Sipërmarrje dhe realizimi i çfarëdolloj aktiviteti të ligjshëm lidhur dhe në shërbim të ngarkimit dhe shkarkimit të anijeve në çdo vendankorim, në porte. - Sipërmarrje, përgatitje dhe realizim i procesit të ngarkimit dhe të shkarkimit të konteniereve, të mjeteve të tjera transportuese, të anijeve, në interes dhe për llogari të pronarit të anijes, përgjithësisht të mjetit transportues, në interes dhe për llogari të pronarit të ngarkesës dhe/ose të porositësit të automjeteve/ trenit, anijes apo porositësve të tjerë të ligjshëm.- Sipërmarrje dhe realizim i ndërmjetësimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave me tren e automjete në interes dhe për llogari të shoqërisë dhe të Porositësve, persona të trete.- Ngarkim dhe shkarkim i trenave; Pritje dhe lëvrim i ngarkesave nga dhe për në stacionet e destinuara; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numërim, pritje, përpunim dhe lëvrim i ngarkesave nga dhe për transport hekurudhor dhe tokësor; - Sipërmarrje dhe realizimi i punëve të ndërmjetësimit, agjencisë dhe transportit në interes të vetë shoqërisë ose të palëve të treta porositëse.

5 Në fushën e mjedisit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të mbrojtjes dhe ose përmirësimit si dhe rehabilitimit të kushteve të mjedisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër, trajtimi i ujrave industriale, projektimin, mbikqyrjen në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kenetave si dhe çdo veprimtari që ka rëndësi për shoqërinë.

6 Krijimi, zoterimi, menaxhimi, mbajtja e te drejtave e ekipeve sportive dhe /ose i klubeve sportive, akademive sportive me qëllim trajnimi organizimi i evenimenteve sportive dhe kulturore, krijimi dhe pjesëmarrja në turne sportive brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrja dhe antaresimi në federata kombetare dhe nderkombetare, pjesëmarrja në evenimente sportive dhe kampionate sportive të organizuara nga federata kombetare dhe nderkombetare të futbollit, institucione publike/shtetërore shqiptare, të huaja apo nderkombetare. nëpërdorim të përkohshëm të tyre. Organizimi i evenimenteve sportive dhe kulturore.

7 Në fushën e prodhimit .



8 në fushën e shërbimeve.

9 në fushën e botimeve publikimeve dhe reklamave.

10 në fushën e tregtisë, import dhe eksport I të gjitha sendeve të qarkullimit civil.

11 në fushën e Telekomunikacionit.

12 në fushën e Energjisë, aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, mbajtjen e depozitave të karburanteve për efekt të aktivitetit të shoqërisë për tregëtimin dhe përdorimin e karburanteve për shkak të veprimtarisë së saj.

13 Në fushën e shitjes dhe blerjes së pasurive të paluajshme, për vetë dhe për llogari të tregëtarëve si ndërmjetës.

Neni 3

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 4

Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

(1) Shoqëria e ka selinë e regjistruar në adresën: Tirane Rruga Dervish Hima, pallati nr.8, kati 3, ap.5, me zone kadastrale 8160, me nr.pasurie 6/348+1-2.

(2) Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe / ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

Titulli II

Kapitali

Neni 5

Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar

(1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 200(dy qind) lekë i ndarë në 1 kuota .

(2) Ortaku merr në pronësi kuotën e kapitalit në përputhje me kontributin e tyre **Z.Fatjon Jonuzi**, kuota me vlerë të përgjithshme **200 (dyqind) Leke**, që përben 1 kuotë, 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Neni 6

Te Drejtat dhe Detyrimet e Themeluesve

(3) Interesat pronësorë që mund të quhen “kuotë” në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

(4) Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

(5) Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

(6) Të gjithë themeluesit apo ndonjëri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirlogarive bankare, blerjen dhe dhënen me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera , janë bashkërisht dhe personalisht



përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

(7) Çdo aksionar ,ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron .

(8) Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave,me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 7

Kalimi i kuotave me kontratë

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratorët. Kalimi i kuotës i njoftohet shoqërisë.

(2) Asambleja e ortakëve me vendim të kualifikuar mund të mos pranojë që administratoret/i të regjistrojnë kalimin e kuotës pranë QKB-së nëse kuota objekt i shitjes nuk ka qenë shlyer tërësisht në kapitalin e shoqërisë.

(3) Nëse Asambleja nuk pranon të regjistrohet kalimi i kuotës, administratoret/i brënda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë blerësit njoftimin për mospranimin.

(4) Pjesë të kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të asamblese të shoqërisë që perfaqesojnë 100 % të kapitalit të shoqërisë dhe vetëm pasi të jetë ezauruar ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ortakët ekzistues.

Neni 8

Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit

(1) Nëse një ortak vdes bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotërues i vetëm ose një bashkëzotërues i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; Por asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës të ky person tjetër.

(3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKB-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke emetuar kuota të reja në favor të ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.



- (2) Me anë të një vendimit të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

Titulli III

Organet drejtuese te Shoqerise

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- 1.Asambleja e Përgjithshme
- 2.Administratori.

Asambleja e Përgjithshme

Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve nga të të gjithë ortakët e të shoqërisë që përfaqësojnë 100 % të kapitalit të shoqërisë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Neni 11

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Administratorët mund të thërrasin mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur ta mendojnë të arsyeshme vetë dhe sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit



dhe sa herë Mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën 1 herë në vit sipas Nenit 82 të Ligjit.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota pune përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 80 % të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i cili duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e Mbledhjes si edhe Rendin e ditës, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhjen nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 12

Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Nenin 86 të Ligjit. Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Të pranishmit në Mbledhje caktojnë si Kryetar anëtarin më të vjetër në moshë për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes, i cili përbën evidentimin *prima facie* të procedimit të mbledhjes, duhet të nënshkruhet nga kryetari i saj dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

(3) Nëse Kryetari i Mbledhjes nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, dhe asnjë anëtar tjetër i Asamblesë nuk pranon të jetë Kryetari i mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.

(4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohe të marrë pjesë dhe në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e pjesëmarrësve në mbledhje, në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhjen e shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të rendit të ditës që do të diskutohet.

(6) Vendimet që duhen miratuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë:

1. Kryetari; ose

2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se 20% të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.
- (7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- (8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

Neni 13

Votat e ortakëve

- (1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.
- (2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.
- (3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 14

Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë noteriale e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

Titulli IV Administratori

Neni 15

Emërimi i administratorit

- (1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator/ë të shoqërisë për një afat të caktuar (jo më shumë se 5 vjet) me të të drejtë rizgjedhjeje. Emërimi i nënshtrohet individualisht një vendimi sipas nenit 10 të statutit të themelimit i cili, nëse miratohet, pas-sjell zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.
- (2) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Nenin 95 paragrafi (2) të Ligjit.
- (3) Administrator i shoqërisë emërohet me vendim të asamblese së përgjithshme të 100 % të ortakëve për një periudhë 5 (pese) vjetecare **Z. Fatjon Jonuzi atesia Muharrem lindur në Trene, ALB me 30.06.1978 banues në Tirane madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Pasaportes nr BB6317120, nr. personal H80630056N.**

(4) Nëse kerkohet shtimi i numrit të Administartoreve, kjo mund të bëhet me kerkese të së paku një aksioneri pavarësisht numrit të kuotave që zoteron aksioneri. Emerimi i Administratorit të dytë miratohet me vendim të asamblese së përgjithshme të 100 % të ortakeve.

Neni 16

Kompetencat e Administratorit

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë administrohet nga Administratori i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit.

(2) Veprimtaria e administratorit duhet të udhëhiqet dhe t'i përmbahet politikave tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

(3) Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij komiteteve që përbëhen nga një ose më shumë Administratorë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohen ose të ndryshohen. Administratorët nuk mund të delegojnë asnjërin prej detyrimeve të cilat ua ngarkon ligji.

A) Të kryejë të gjitha operacionet financiare dhe/ose tregtare, aktive dhe pasive në lidhje me operacionet që janë të përfshira në objektin e shoqërisë duke marrë angazhimet dhe kryerjen e formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dënimin e dorezave, gjithashtu në kufijtë e sa është parashikuar me siper ;

B) Të sigurojë për llogarinë, në emër dhe në interes të shoqërisë në marrjen dhe tërheqjen e të gjitha shumave dhe vlerave që i detyrohen shoqërisë për çfaredo shkak nga çfaredo person, si edhe nga administratat e Shtetit dhe nga organet e pushtetit lokal dhe në përmbartjen e mandateve që janë emetuar ose që do të emetohen në të ardhmen, pa kufizime kohore, në favor të shoqërisë për çfaredo shume të kapitalit ose interesa që i detyrohen asaj nga administratat e sipërpervendura dhe nga zyrtarët dhe institutet e mesipërme, si në likuidim të depozitave të bera nga vete shoqëria, ashtu edhe për çfaredo shkak ose titull, të leshojë në emër të shoqërisë deklarata përkatëse të faturave dhe të shkarkimit dhe në përgjithësi të gjitha deklaratat që mund të kërkojnë për përmbartjen e secilës prej praktikave duke përfshirë edhe ato të përjashtimit të zyrtarëve, administratave dhe institutëve të mesipërme nga përgjegjësia në lidhje me to ;

C) Të përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjyqimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse pra edhe me lëshimin e prokurave, mandateve të veçantë për avokatë, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarrëveshje;

D) Të lëshojë ose të revokojë mandate të avokatëve dhe mbrojtësve dhe punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;

E) Të paguajë kambiale, xhiroje, paguajë dhe njohe çeqe bankare, kambiale dhe çdo lloj titulli kredie, dergesa të hollash me poste të pagueshme në përgjithësi pranë çdo personi fizik ose juridik ;

F) Të çelë llogarinë rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pagesës, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe të zbuluar, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (overcover), të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;

G) Të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;

- H) të ndërveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- I) Te marre masa per llogari, ne llogari, ne emer dhe ne interes te shoqerise per krijimin e Shoqerive te Perkohshme te Siper marrjeve, ne cilesine e shoqerise te perfaqesuar ose perfaqesuese, per projekte qe jane te perfshire ne objektin e shoqerise ;
- J) të lëshojë ekstrakte të borderove dhe vërtetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përbushjeve ndaj të cilave shoqëria është e detyruar me të drejtën për të nënshkruar deklarata tatimore që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;
- K) të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose çertifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësime nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkalle, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;
- L) të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e koncesioneve, licencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;
- M) të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstarakte periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;
- N) të nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;
- O) të mbajë dhe të nënshkruajë korrespondencën e shoqërisë;
- P) të emërojë të perfaqesues të posaçëm për të tërhequr vlera, letra postale, pako, letra rekomande dhe të siguruara pranë zyrave postale dhe telegrafike;
- Q) të tërheqë vlera, letra postale, pako, letra rekomande dhe të siguruara pranë zyrave postale dhe telegrafike;
- R) të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe operacioni pranë zyrave të postës dhe telegrafit;
- S) të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe operacioni pranë zyrave pranë zyrave hekurudhore, doganore, të postelegرافit dhe në përgjithësi pranë çdo zyre publike dhe private të transportit, me kompetencën për të leshuar deftesat perkatese të lirimit, deklaratat e shkarkimit dhe lejimit të detyrimit dhe clirimit nga detyrimi;
- T) të përfaqësojë shoqërinë në zhvillimin e të gjitha praktikave që kanë të bëjnë me veprimtarinë e importit dhe eksportit;
- U) transmetimin e dokumentave, të dhënave dhe njoftimeve;
- V) të ndërtojë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakort mbi afatet dhe kushtet;
- W) të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumenteve të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
- X) të përfaqësojë shoqërinë në asamblëtë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues ad negotia;



Y) t'i japë ekzekutim, në kufijtë e kostos së parashikuar nga planbiznesi dhe nga buxheti i shoqërisë, i miratuar paraprakisht nga Asambleja e Ortakeve, investimeve dhe veprimtarive të parashikuara në to;

Z) të delegojë me mandat dhe/ose prokurë sa i takon kompetencave të tij. Perdorimi i firmes dhe perfaqesimi para te treteve i perket edhe secilit prej përfaqësuesve ne kufijte e kompetencave qe u jane dhene atyre.

AA) Administratori eshte i detyruar qe per cdo veprim te tij ne funksion te ushtrimit te detyres, te informoje me shkrim ne menyre elektronike ne nje nga adresat e konfirmuara, aksioneret.

Neni 17

Shkarkimi dhe largimi i administratorëve

(1) Funkzioni i Administratorit lirohet nëse:

1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, statutit dhe aktit të themelimit.
2. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
4. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Administratorëve të tjerë, vendos ta shkarkojë nga detyra;
5. Me kerkese, se paku te njerit prej administratoreve, kerkohet dhe vendoset shkarkimi i tij edhe me kerkese te pamotivuar.

Neni 18

Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve

- (1) Administratori ka të drejtë të marre shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Administratorëve u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që u lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Administratorëve apo të komiteteve të Administratorëve ose në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme apo mbledhje të veçanta të zotëruesve të klasave të aksioneve të shoqërisë, si edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

Titulli V

Dividendët dhe kapitalizimi i fitimeve

Neni 19

Dividendët

- (1) Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të asamblese se pergjithshme te 100 % te ortakeve, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuota emetohen me kushtin sipas të cilit dividendit mund të merret duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e përfiton dividendin sipas këtij kushti.
- (3) Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

(4) Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë por ta administrojë atë në formën e miratuar në Mbledhjen e Asamblesë me vendim të kualifikuar.

Titulli VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 20

Prishja dhe likuidimi

(1) Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep vendimi të asamblese se përgjithshme të 100 % të ortakëve dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Neni 21

Njoftimet

(1) Njoftimet që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në Nenin 4 paragrafi (3) të këtij Statuti që është e vlefshme në momentin dhe që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bën njoftimin.

(2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me postë në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje me Nenin 72 paragrafi (2) të Ligjit.

(3) Në këtë Statut përfshihen shtesa dhe ndryshime, dhe të gjithë dokumentet e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë që vendosen nga Administratorët në hapësirën në internet të shoqërisë të parashikuar në Nenin 4 paragrafi (2) të këtij Statuti.

Neni 22

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 23

Prishja dhe likuidimi

(1) Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jete :

- Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji “ Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare”
- Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

(2) Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo



dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 2 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare “HFM” Shpk , dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur ne fund emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale.

Shoqëria “HFM” Shpk
Ortaku i vetem

A handwritten signature in blue ink, which appears to read "Fatjon Jonuzi". The signature is stylized and includes a large circular flourish at the end.